



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJ & I P-A

Nr. 1463 Prot.

Tiranë, më 17.09.2025

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Të nderuar,

Rektorati i Universitetit të Arteve shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune sa më poshtë:

➤ **FAKULTETI I ARTIT SKENIK**

- **Specialist/e i/e kurrikulës dhe komunikimit me studentët**

I. KRITERET PËR KANDIDATËT

I.1. KRITERE TË PËRGJITHSHME:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje.
5. Të mos ketë marrë ndonjë masë disiplinore për largim nga detyra.

I.2. KRITERE TË VEÇANTA:

1. Të zotërojë diplomë Master Shkencor ose Master i Arteve, ose diplomë të sistemit të vjetër 4-vjeçar.
 - 1.1. Në rast se studimet janë kryer në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të ketë së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në pozicionin për të cilin konkurren ose të ngjashme me të.

3. Të jetë njohës i një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
4. Të ketë njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi VKM-të dhe udhëzimet e MAS për arsimin e lartë dhe procedurat administrative.
5. Të ketë njohuri të mira kompjuterike.
6. Të jetë e komunikueshme dhe të ketë aftësi të punojë në ekip.
7. Të jetë fleksibël dhe të ketë aftësi menaxhimi në situata të ndryshme në punë.
8. Të ketë vlerësime pozitive pune nga punëdhënësi i fundit.

Kritere kualifikuese përbëjnë kriteret e përgjithshme, së bashku me kriteret e veçanta, pikat 1 dhe 2. Mosplotësimi i këtyre kritereve përbën shkak për skualifikim të kandidaturës.

II. PËRMBAJTJA E DOSJES (DOKUMENTACIONI)

Sa më sipër, kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ-P/A:

1. Letër motivimi për pozicionin e punës për të cilin konkurron;
2. Fotokopje të noterizuar të diplomës që vërteton kryerjen e arsimit të lartë. Për kandidatët që kanë kryer studimet jashtë vendit, dokumenti për njohjen dhe njehsimin e diplomës;
3. Fotokopje të noterizuar të listës së notave;
4. Fotokopje e noterizuar të librezës së punës, që vërteton përvojën në punë;
5. Jetëshkrimi (CV) në gjuhën shqipe, ku të jetë përfshirë edhe adresa e postës elektronike, i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
6. Letër reference/vlerësimi pune nga punëdhënësi i fundit;
7. Dokumente të tjera plotësuese si: fotokopje e noterizuar e certifikatave apo diplomave të trajnimeve ose kualifikimeve pasuniversitare në fushën përkatëse, nëse ka;
8. Dëshmi të mbrojtjes së një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
9. Kopje e kartës së identitetit;
10. Vetë deklaram i gjendjes gjyqësore, sipas formatit bashkëngjitur;
11. Dëshmi e gjendjes mjekësore.

III. DORËZIMI I DOSJES, AFATI DHE NJOFTIMET

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurimit në njoftimin publik, dorëzohet fizikisht, nga vetë kandidati, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ & I P-A në Universitetin e Arteve, nga data 22.09.2025 deri më datë 06.10.2025, nga ora **09:00** deri në orën **14:00**.

Vetëm kandidatët të cilët do të plotësojnë kriteret kualifikuese, do të njoftohen për të marrë pjesë në fazën e mëtejshme.

Kandidatët e kualifikuar do të informohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ & I P-A përmes postës elektronike, si dhe për çdo pyetje apo paqartësi, çdo ditë, nga ora 09:00 deri në 14:00.

IV. VLERËSIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët të cilët do të vazhdojnë në fazën e mëtejshme të konkurrimit do të vlerësohen si më poshtë:

- Vlerësimi i testit me shkrim – deri në 60 pikë. Kandidati duhet të marrë minimalisht 30 pikë në mënyrë që të vazhdojë me vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistën e strukturuar me gojë. Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:
 - Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
 - Njohuritë mbi ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
 - Njohuritë mbi Statutin e Universitetit të Arteve.
- Vlerësimi i jetëshkrimit (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimit, vlerësimin e përvojës dhe vlerësimin e trajnimeve e kualifikimeve të lidhura me fushën – deri në 15 pikë.
- Vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë, që lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës – deri në 25 pikë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

REKTORI



Prof. Dr. Erald Bakalli